



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR**

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër, ëeb: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al, Tel: +35522400150

PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN

PËR

**“DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESËM 2023-2025 TË
BASHKISË SHKODËR ”.**

Konsultim publik: *Rajoni/Lagjja nr. 5*

Data: 20.10.2022

Ora: 13.00

Vendi: *Salla e Keshillit Bashkiak Shkoder.*

Numri i pjesëmarrësve: *Numri i pjesmarresve 53, nga të cilat 12 gra dhe vajza.*

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet: *Për draft projekt planin buxhetor afatmesem 2023-2025 të Bashkisë Shkodër*

Pjesëmarrës: Drejtues dhe specialiste te administrates se Bashkise Shkoder dhe banorë (Bashkangjitur liste prezenca).

Takimi bashkë-drejtohet nga Zv.Kryetari i bashkisë dhe Kryetarja e Këshillit Bashkiak të cilët bënë një prezantim të shkurtër në lidhje me:

- ✦ Projekt-aktin e propozuar
- ✦ Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- ✦ Dha informacion për mënyren e dhënies së rekomandimeve.
- ✦ Ju dha fjalën pjesëmarrësve

Pjesëmarrësit që morën fjalën, diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet janë si vijon :

Hapja konsultimit nga Zv/Kryetari i Bashkisë, fjala përshëndetëse dhe prezantimi i pjesëmarrësve pjesë e stafit të Bashkisë Shkodër në takim.

Rendesia e takimit qendron në marrjen e opinioneve dhe mendimeve të banorëve sa i përket nevojave për investime në vitin 2023.

Do të ndjekim axhenden e caktuar sipas funksioneve dhe përgjegjësi të bashkisë.

1. Arsimi i baze, parashkollor dhe i mesem

Gjek Sokoli – anetar i keshillit bashkiak – bëhet fjalë për konviktin e shkolles industriale, kemi të bëjmë me të njëjtin frekuentues, janë shpenzuar 3 milion euro në këtë konvikt nga ana e qeverisë shqiptare, ideja është se përse është bërë ky transferim dhe si do të veprojë në të ardhmen.

Që në vitin 1991 është i njëjti trajtim që i bëhet nxënësve dhe me vlerën e përcaktuar prej 2200 lek të vjetra është shumë e vështirë që të bëhet përballimi I shpenzimeve

Sygjerimi im është që nxënësit të ritransferohen në shkollën industriale nga konvikti i shkolles Preng Jakova

Zv/ kryetari – do të verifikohet nga stafi dhe të vendosen në buxhet për vitin tjetër

Sokol Zaimaj – Shkolla “Deshmoret e Prishtinës”

1. Shkolla ka shumë nevojë për nderhyrje kemi akoma pllakat e 25 viteve me parë
2. Oborri i shkolles tej mase i amortizuar
3. Dyert dhe dritaret gjithashtu
4. Është një problematike e diskutuar edhe me parë dhe akoma nuk është marrë asnjë masë për rikualifikim të ketyre ambjenteve.
5. Kërkojmë edhe një vendparkim për makinat e mesuesve

Kemi 4 vite që i kërkojmë këto nevojë dhe ka shkolla që kanë marrë investime por ndërkohe nuk mirembahen.

Cdo mirembajtje që bëjmë në këto shkollë është tashmë shumë e vështirë nga ana e stafit, është vendosur në dijeni edhe drejtoria ekonomike e arsimit dhe akoma nuk kemi një nderhyrje.

Nen kryetari – do të shenohet dhe paraqitet si prioritet, janë nevojë që janë marrë me vite por akoma nuk kemi gjetur mundësi të financimit. Në do të bëjmë analizën e posaçme sa i përket mundësisë së financimit.

Sokol Zaimaj – kemi tërhequr vëmendjen edhe për investimet e kaluara, bëhen llyerje të jashtme dhe të brendshme në shkollë të ndryshme investohet edhe për kaldajën duke i përqendruar investimet në të njëjten shkollë.

Ndërkohe nuk është e drejtë që fondet të mos shpërndahen paralelisht.

Është nderhyrë 3 – 4 here në shkollën “Azem Hajdari” – shkolla “Ndoc Mazi” etj. Dhe investimi nuk është mirembajtur, dhe ndërkohe shkolla “Deshmoret e Prishtinës” akoma asnjë investim.

Janë bere nderhyrje pjesore nga shoqata apo donator por asnje here nje investim i qenesishem.

Nen kryetari :Do te verifikojme situaten dhe do ta shohim me prioritetet.

2. Menaxhimi i mbetjeve

Cilat janë sygjerimet sa i përket pikave te grumbullimit frekuences? etj.

Shan Leka – banor Mark Lula : Bashkia Shkoder qe nga ‘91 nuk ka nderhyre sa i përket pastrimit ne kete zone jemi pagues te taksave dhe asnje investim apo pika grumbullimi nuk ka.

Nen kryetari – a ka rrjet te pikave te grumbullimit ne lagjen Mark Lula?

Alfred Luleta – ka rrjet ne te gjithë Shkodren përsa i përket pastrimit dhe pikave te grumbullimit.Pikat e grumbullimit janë te përcaktuara me administratoret dhe inspektoret e lagjeve, ne jemi ne përfundim te procedures për blerjen e kazanave te rinj dhe nqs do te kete nevojë do te shtohen ne vendin ku thoni ju.

Gjek Sokoli – problem është se ne rrugën “Milan Shufraj” “Mehmet Shpendi”etj rrugët e reja nuk janë te plotësuar me sherbimet e tjera publike.

Vendosja e xhepave për koshat e mbeturinave duhet te vijojë dhe te zbatohet. Jo vetem ne lagjen tone por edhe ne zona te tjera te shkoderes.

Nen kryetari – me sa kuptohet nevoja është qe te shtohen pikat e grumbullimit ne lagjen nr. 5 .

Banore rruga “Ded Gjon Luli “ – dy kazanat e grumbullimit janë pa kapak ,shkojne edhe kafshet e rrugëve duke i hedhur ne toke dhe krijuar mjedis te papastert dhe kërkojmë zevendesimin dhe riparimin e tyre.

Sokol Zaimaj – gjate rrugës për tek Arra e Madhe shohim qe rrugicat janë te papastruara dhe nuk ofrohet sherbimi i fshirjes. Gjithashtu duhet te behet pastrim tek pikat e grumbullimit te mbetjeve dhe te dizinfektohen

Nen kryetari – do te verifikojme situaten është pjese e kontrates qe te behet pastrimi

Banor i lagjes 3 – fshirja duhet te behet sipas frekuencave dhe kontrates ,rruga prane stacionit te trenit.

Banore lagjja 3 herojt – prane rrugës “Ruzhdi Tyli”(Stacioni i trenit) ka nevojë edhe për rikualifikim te mjedisit publik me lulishte. Zona është me shumë banore dhe ka nevojë për nje ambjent te gjelberuar lulishte apo shesh rekreativ.

Z. Ceka rruga “Edith Durham – tek ish hotel sporti i vjeter ka vetem 2 kazanat është nje zone e populluar dhe nga 4 janë 2 tani nderkohe nevoja është shumë e madhe për te pasur shtese te kazanave ne kete pike.

Col Naborri – lagjja “Tre herojt” janë mbi 137 familje dhe me ato mundesi qe ka firma pastrohet por ka pasur te planifikuar 4 kazanat dhe tani ka vetem 2 kërkojmë qe te behet shtese e kazanave ne kete pike grumbullimi.

3.Rrjeti Rrugor

Lagjja Mark Lula – banore: kemi probleme me infrastrukturen rrugore ne kete zone është nje rrugë e pa rikualifikuar asnje here dhe asnje investim nuk është kryer ne kete rrugë rruga Klejla Meloni ,është shumë problem për te gjithë banoret dhe kalimtarët ne kete rrugë.

Rruga Vllaznimi është bere investimi itre rrugicave dhe kanë mbetur edhe tre te tjera ,ka qene si projekt për tu përfunduar por nuk është marre akoma asnje mase. Ka 2 vite qe ka përfunduar rruga por akoma nuk është vendosur ndriçimi

- 1. Rruga Suga e Kunores**
- 2. Kapre**
- 3. Shuk Radoja**

Kanalizimet KUZ janë realizuar nga vete banoret dhe është e nevojshme qe se paku te behet asfaltimi dhe ndriçimi i ketyre rrugicave. Edhe me riparimet e bera nga bashkia nuk ka asnje investim riparues ne kete zone. Nuk ka ndriçim dhe kjo përben problem për sigurine publike dhe parandaluar aksidentet. Se paku 5 ndriçues duhen vendosur.

Janë disa puceta te hapura ne rrugën Gjon Buzuku dhe gjithashtu ne trotuar ,ka aksidente te njerezve dhe femijeve qe shkojne për ne shkolle dhe duhet te nderhyhet medeomos . Puceta dhe dritat janë investime dhe nderhyrje qe duhet te behen menjehere se nuk kerkojne investime te medha.

Nen Kryetari – Investimi i kerkuar do te vijojë dhe do plotesojë edhe rrugicat e mbetura, riveshje e segmentit rrugor “Gjon Buzuku” dhe plotesim i sistemit te ndriçimit .

Gjek Sokoli – Qendresa 1915 Nard Kiesa dhe Dom Mazreku janë investuar nga vete komuniteti dhe përvec investimit te bere për rrugën Mehmet Shpendi qe kanë asistuar për sistemin KUZ te gjitha janë investime private.

Mund te gjindet hapesira për te bere bashkefinansim me bashkepunimin e banoreve dhe specialisteve por duhet qe te kemi investime ne kete zone nga ana e bashkise.

Është nje komunitet i harruar ne 30 vite.

Jona Leqejza – është e vertet kjo pjese dhe është kenaqesi qe salla është plot sot për sa i përket problematikave te kesaj lagjeje. E dime qe ka shumë problematika dhe është rajoni me i diskriminuar nga bashkia Shkoder.

Asnje kryetar nuk e ka marre ne konsiderate investimin ne kete zone.

Nen kryetari – jam dakort dhe i bindur qe bashkefinansimet me komunitetin janë me te suksesshmet dhe aty ku gjejme kete bashkepunim duhet te nderhyhet i pari.

Ernes Marku lagjja 3 herojt. Jam banor qe 30 vite dhe rruga “Gjon Gazulli” është prioritet për ne dhe na është premtuar ne vite qe do te realizohet. Para shumë vitesh kemi bere edhe investim nga komuniteti deri ne rrugën “Mirash Ivanaj” dhe akoma nuk kemi nderhyrje ne kete rrugë, është nder me te amortizuarat ne Shkoder ka rreth 400 punetore përvec banoreve qe jetojne ketu është

ne midis te Shkodres. Na është premtuar qe do te jete investimi i pare dhe ka kaluar tetori dhe akoma nuk ka asnje investim. Pjesa e fondeve për ne nuk ka rendesi por investimi është emergjent aq me tepër qe ka edhe rreshje tashme dhe nuk mund te kalohet.

Nen Kryetari – përgjigja për mungesen e fondeve është shqetesuese, megjithate nqs është vendosur ne prioritet do te gjindet mundesia për te nderhyre.

Banor i lagjes: U përmenden njerezit qe punojne ne zone por duhet pare ne thelb kjo problematike sepse ka banore qe jetojne ne zone, janë punetoret qe punojne dhe investime te metejshme ne fasoneri mobileri etj dhe nje bashki qe premtun me vite dhe sot serisht diskutojme te njejten gje. Zona duhet qe te mbështetet meqenese ka kaq shumë biznese dhe banore nuk duhet te lihet pas dore.

Mungesa e infrastruktures pengon rritjen e ketyre investimeve, duhet te verifikohet nga specialistet e bashkise kjo rrugë.

Gjithashtu kemi kerkuar edhe ndertimin e nje kopshti për ti ardhur ne ndihme punojseve qe kalojne ne kete rrugë.

Ndoc Ashta - edhe un jam banor ne kete zone ,rruga Mirash Ivana ka filluar ne 3 vite dhe 1 / 3 e rrugës nuk ka përfunduar akoma .Ne buxhetin 2020 – 2021 është parashikuar nderkohe për 2022 nuk ka asnje fond te alokuar . Janë biznese te medha dhe shumë punojes qe shfrytezojne kete rrugë përvec banoreve.

Rruga nuk ka as uje te pijshem dhe te gjitha shkarkimet e ujrave te zeza me siguri , duke qene se kemi shpime dhe puse , ndoten nga keto shkarkim.

Rruga “Gjon Gazulli” është prioritet dhe duhet te parashikohet nderhyrje thelbesore me KUB KUZ dhe asfaltim dhe rrjet te ujit te pijshem. Behet fjale për nje rrugë prej 300 metrash linear – janë 6 biznese te medha, kemi bere investime private dhe jemi serisht te gatshem për te bashkeinvestuar.

Nen kryetari – fakti qe është e parashikuar qe vitet e kaluara e ben edhe me prioritet realizimin e kesaj rrugë. Investimet qe zhvillohen behen te plota edhe me KUB, KUZ dhe rrjetin e ujsjellesit.

Renato Cardaku – rruga “Roza Lejn” ne e dime qe ka prioritet për investimet kemi dergu edhe me shkrese kerkesen me firma te 80 banoreve meqe ka prioritate na tregoni se cilat janë keto. Amortizimi është maksimal ,rendesia strategjike është e larte sepse ka shkolla qe lidhen me kete rrugë ,taksat paguhen nga te gjithë banoret mund ti verifikoni, jemi banore ne kete zone pavarsisht te rinj apo te vjeter dhe kërkujmë qe te respektohem.

Nen kryetari – deshira e jone është qe te kemi mundesi te investojme kudo por ka kritere ka edhe historik te investimeve por përher pa pasur diskriminim.Prioritet është normalisht nr. i banoreve lidhja me qendra urbane, aksesit, kostoja etj. Duke qene se rruga qe propozoni është kaq e amortizuar dhe ka kete rendesi strategjike do te jete ne prioritetet e bashkise.

Gjek Sokoli – është e qarte dhe e dukshme për te gjithë qe është prioritet maksimal ështërealizimi i ketij investimi.

Jona Leqejza- është teme shumë e debatuar fakti i kritereve , megjithate keshilli ka propozuar nje sistem te unifikuar pikezimi i cili akoma nuk është realizuar nga stafi teknik dhe ne nuk kemi nje instrument te tille te miratuar.

Fakti qe nuk janë as ne projektim do te thote qe nuk ka iniciuar akoma asgje.

E vetja gje e buxhetuar është ndriçimi rrugës Gjon Gazulli edhe kjo e parealizuar

1. Rruga “Roza Lejn”
2. Rruga “Gjon Gazulli”

Mund te jene prioritetet kryesore për te gjithë lagjen dhe komunitetin .

Ardita Begovic banore lagjja “Ndoc Mazi “– kemi probleme sa i përket rrugëve:

1. Dom Ndrej Zadeja – është gjysma e asfaltuar dhe nuk ka kanalizim te ujrave te zeza.
2. Edhe blloku I pallateve prane ish policise
3. Rruga Pashko Vasa është e degraduar totalisht
4. Rruga prane restorant “Ttradites”

Janë rrugë qe i sherbejne taksapaguesve dhe banoreve te vjeter te ketyre zonave.

Nen kryetari – vendosja ne vend e nevojave është me rendesi për keto degjesa. Nevoja për te investuar është e madhe dhe ne si administrate duam ti realizojme te gjitha ,por mundesia është e vogel dhe duhet bashkerisht te prioritarizojme keto nderhyrje.

Sokol Zaimaj – rrugice e sistemuar ne 60 % te saj ,janë ndoshta vetem 50 metra për tu nderhyre, është bere edhe investimi i pallatit (Xhedis) dhe kjo pjese e shkurter mund te realizohet.

Investimi tek kisha e Arres se Madhe, është zone e vecante dhe nga kryqezimi i rrugës deri tek kisha ka nevoje për rikualifikim.

Rruga Arra e madhe me pak rreshje përmytet dhe duhet te verifikohet.

Ermaj Rripaj – lagjja Ndoc Mazi – rruga “Risto Siliqi” është nje rrugice qe historikisht përmytet dhe ka 50 vite qe është e njejta situatë përmytjeje .Ne kete rrugë është edhe shtepia e Pashko Vases dhe lidhje me Kishen e Arres se Madhe , ka shum vite qe është nuk investuar ne kete rrugë dhe amortizimi është maksimal tashme edhe nga nderhyrjet e vete banoreve.

Ka edhe dy shtylla tensioni qe janë rrezik përmanent për banoret dhe kalimtarete.

Nje nderhyrje sa i përket arsimit – kam qene pjese e sistemit arsimor për 21 vite – dua te diskutoj sa i përket asfaltimit te rrugës prane shkolles Martin Camaj ku ka shumë problem hyrja ne kete shkolle ku është edhe drejtoria arsimore

E gjithë zona përpara shkolles është shumë e amortizuar dhe ka nevojë për investim për t’ju sherbyer edhe femijeve dhe nxenesve qe hyjne dhe dalin nga kjo shkolle.

Andi Halluni – Anetar i Keshillit Bashkiak – është i vetmi rajon qe ka nje përgjegjshmeri kaq te larte dhe dua te falenderoj pjesemarresit.

Rruga ‘Malet tona’ – 300 metra rrugë ne te cilen nuk është investuar asnje here, përvec investimit privat nga ana e banore.

Nje tjetër problem ne lidhje edhe me policine bashkiake ka te beje me tregtimin nga ambulantet ne rrugën e Qaf Hardhise , krijohet shumë trafik nga zenia e hapsires publike dhe duhet pare mundesia qe te spostohen nga kjo rrugice.

Tre rotondot ne unazen lindore te lagjes nr. 5 ne fund te rrugës “Qafe Hardhi” – tepe dhe Edit Durham janë pa asnje sherbim nga ana e gjelberimit.

E dime qe nuk është marre ne dorezim pjesa e unazes por kur do te përfundoje ky proces ? ?

Duke qene se rruga e unazes lindore nuk ka trafik te larte propozoj qe nje ane e kesaj rrugë te behet parkim

Nen kryetari – do te dergojme për verifikim policine bashkiake për te nderhyre ne lirimin e hapsires publike.

Për sa i përket marrjes ne dorezim duhet te komunikojme me specialistet për te marre informacion sa i përket praktikes me ARRSH.

Edhe për parkingun do te verifikojme edhe me Policine e Shtetit krijimin e mundesise për parkim publik.

Banor i lagjes: Rruga nga plepi për tek stacioni i trenit ka nevoje qe te kete nje bum ose sinjalistike parandaluese te shpejtesise se makinave.

Planifikim i lulishtes prane pallateve ne vend te parkimit te makinave prane rrugës se trenit. Pallati 1205

Ardita Begovic – nga ura e Bahcallekut deri tek Shqiponja ka shumë bume dhe pengesa kalimit se paku te zbuten kjo sinjalistike penguese.

4.Ujesjellesi

Sokol Zaimaj – kemi shumë problem me presionin e ujit dhe te gjithë pallatet nuk kanë furnizim.

Pallatet tek stacioni i trenit po ashtu kanë problem me furnizimin.

5. Sherbimi shendetsor – Qendrat shendetsore

Banor i lagjes: Qendra jone shendetsore është tek Adisa – tek konvikti ,situata është shumë e keqe dhe vetem qender shendetsore nuk mund te quhet, nuk po kërkojmë spostim po se paku sistemim te saj , është skandal ambjenti i përbashket me konviktin dhe te strehuarit dhe pacientet dhe stafin.

Anetare e keshillit bashkiak – kemi kerkuar edhe ne zgjidhjen e kesaj suate dhe se shpejti do te sistemohet.

Sokol Zaimi – mjedisi gjelberimi ,biznesi privat dhe banoret kanë problem nga pemet e medha qe kanë nevoje për krasitje dhe për sistemim te trotuareve te shkaterruara nga rrenjet.

Nen kryetari – gjate kesaj periudhe eshte duke u zbatuar procesi krasitjes se pemeve dhe do te jete ne vemendje tone per ta adresuar kete problematike.

Nen kryetari:

Duke ju falenderuar per opinionet dhe nevojat e paraqitura ju falenderoj serisht dhe shpresojme qe te kemi mundesine te realizojme keto propozime te bera sot ketu nga ana juaj.


Pyetje dhe diskutime te tjera nuk ka. Mbledhja deklarohet e mbyllur.

Mbajtësi i Procesverbalit:

Bekim Mema








BASHKIA
SHKODËR

Këshillim me publikun -Për draftin e projektplanit buxhetor afatmesëm 2023-2025.

Lagja nr.5

NR	EMER	MBIEMER	GJINIA	MOSHA	VENDBANIMI	PROFESIONI	PUNESIMI
1	Nbloc	Ashta	M	62	Lagj. N. 5	Jurist	Basok. Shkoder
2	Fleuran	Hoxhig	M	67	Shkoll. St. Trepur	Pemencorist	
3	Fekal	Zaimig	M	58	Nbloc Nr 2	Arziner	A. Prigjethor
4	Agim Saher	Solep	M	55	M. Shkoll. Shkodër	Jensur	A. K. U-
5	Ambi	Hallung	M	48	Shkodër	Jensur	Prigjethor
6	GJERGJ	NIKA	M	59	SHKODER	800-KIMI	bashk. Shkodër
7	Ejell	Leke	M	78	Dr. balt Duzhani	Penjonist	Ekonomik
8	Malvina	Arkeget	F	33	Rn. Voolha.	Financier.	Specialist.
9	Masniku	Gjergj	F	38	Shkodër	Ekonomist	B. Shkodër
10	Joana	Miraj	F	35	Shkodër	Gjeomik	B. Shkodër
11	Blerta Myrda	Shkodër	F	42	Shkodër	Financier	B. Shkodër
12	Aleksandra	Ashta	M	26	Shkodër	Financier	Privat
13	Andrea	Ashta	M	19	Shkodër	Student	

COORDINATORI PER KONSULTIMIN PUBLIK




BASHKIA
SHKODËR

Këshillim me publikun -Për draftin e projektplanit buxhetor afatmesëm 2023-2025.

Lagja nr.5

NR	EMER	MBIEMER	GJINIA	MOSHA	VENDBANIMI	PROFESIONI	PUNESIMI
14	Enfer	Polen	M	44	Shkodër	Arb	
15	Enfer	tesher	M	58	de Mosh dulo	Cheresh	Sot Jap
16	Jon	Jon	M	60	de Mosh dulo	-	FTUR
17	Aldin	Yoshi	M	44	Rr. GJ. Gazulli	Dokumant	STC GRID
18	Klodiana	Hollomat	F	29	Shkodër	specialist mjedisi	PP
19	Armbra	Tukej	F	27	Shkodër	Specialiste Mjeksi	Bashkia Shkoder
20	Xhulio	Haxhije	M	30	Shkodër	Specialist Stallum	Bashkia Shkoder
21	Enfer	Haxhi	F	52	Shkodër	drejtor buxhet	Drejt buxhet
22	Rindun	Olyvesko	F	49	- -	Drejtore Juvenile	Drejtore
23	Alfred	Shkoder	M	56	"	Punist	B. Shkoder
24	Moje	Shpenoli	F	62	L.5	Pensionist	
25	Tom Spasari		M	66	45	Futur Shopot	
26	Tom Spasari	Monashti	M	50	L.5	MLK SHK	7

KOORDINATORI PER KONSULTIMIN PUBLIK




BASHKIA
SHKODËR

Këshillim me publikun -Për draftin e projektplanit buxhetor afatmesëm 2023-2025.
Lagja nr.5

NR	EMER	MBIEMER	GJINIA	MOSHA	VENDBANIMI	PROFESIONI	PUNESIMI
27	Fram	Gjeba	M.	58	M. Shkemoli	UKSH	
28	RENATO	SAKELAKU	M	29	EKONOMIST	PRIVAT	EKONOMIST
29	Pal	Penaj	M	55	Shkolltar	inxhinier	Mer-Art. S. S.
30	Pellumb	Zepi	M	50	L. M. Lule	Ekonomist	Publik
31	Grele	Cajmaj	M	58	X. M. Lule	Heteraner	Banor
32	Prof	Bushaj	M	67	L. M. Lule	Pensioner	Publik
33	Don	Doshaj	M	55	d. Morhela	Shkolltar	Publik
34	Andrita	Borriq	F	55	L. Ndoc. Naim	Shkolltar	Publik
35	Erman	Bushaj	M	47	H. Ndoc. Naim	U. K. SH	Publik
36	Roze	Rushaj	F	42	L. TRE HERONJES	MonxhTunza	Privat
37	Leke	Kelens	M	50	Loft Nr 5	Jurist	Privat
38	Arifem	Maqolaj	M	51		Inspektor	Publik
39	Jaar	Saholi	M	26	L. Naim Gjylbegu	IT	Publik

KOORDINATORI PER KONSULTIMIN PUBLIK



BASHKIA
SHKODËR

Këshillim me publikun -Për draftin e projektplanit buxhetor afatmesëm 2023-2025.
Lagja nr.5

NR	EMER	MBIEMER	GJINIA	MOSHA	VENDBANIMI	PROFESIONI	PUNESIMI
40	Abdi	Selva	M	52	Shkollor	Profesor	B. Shkollor
41	Gjergj	Kurbi	M	53	- " -	Burist	- " -
42	Abdi	Ardiq	M	63	- " -	Inspektor	B. Shkollor
43	Adlee	Braci	M	53	- " -	Mexhan uSh.	B. Shkollor
44	Armed	Marku	-	54	- " -	Funqioner i shkolle	-
45	Cherashkin	Marku	-	56	- " -	Mexhanor	-
46	Mark	Gjean	M	41	5	Profesor	-
47	Niko	Papshaj	M	35	-5-	Profesor	-
48	Paulin	Zheri	M	30	5	Hydrocentru	Shkollor
49	Styrolim	Osmani	M	62	5	-	-
50	Adriani	Vilca	M	68	5	Profesor	-
51	Ernest	Marku	M	63	5	Burist	-
52	Gidon	Teubin	M	29	Shkollor	Profesor	-

Kristina Doshina

KOORDINATORI PER KONSULTIMIN PUBLIK

